



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKT-VENDIM

PËR

I. **MIRATIMIN E FUNKSIONIMIT TË GRUPEVE ME 5-10 NXËNËS, NË NJËSITË ADMINISTRATIVE, PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 23 “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike” pika 12. “Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe”.

Ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Urdhërin nr 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”

Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2023 “Për numrin e nxënësve dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”

Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbledhjen e datës __.09.2025.

V E N D O S I:

1. Të miratojë, funksionimin e grupeve me 5-10 nxënës, në 18 kopshtet e 4 njësive administrative për vitin shkollor 2025-2026, si më poshtë:

Nr	Njësia administrative		Kopshti	Nr i fëmijëve
1	Roshnik	1	Roshnik	6
		2	Karkanjoz	7
		3	Vojnik	5
2	Sinjë	4	Paftal	6
		5	Mbjeshovë	9

3	Velabisht	6	Molisht	7
		7	Gjoroven	5
		8	Veleshnje	7
		9	Drobonik	7
		10	Bilçë 1	7
		11	Bilçë 2	5
4	Otllak	12	Orizaj	5
		13	Ullinjas	9
		14	Lapardha 2	9
		15	Lapardha Qendër	10
		16	Lapardha Qoshk	10
		17	Moravë Hatillarë	5
		18	Moravë Stan	7
Ps	Mbyllen		<i>Bogdan</i>	1
			<i>Remanice</i>	2
	Totali i grupeve qe mbeten hapur	18		126

2. Për vitin shkollor 2025-2026 ne Bashkine Berat do të funksionojnë me 36 kopshte.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit, Bashkia Berat.

K R Y E T A R
I K Ë S H I L L I T B A S H K I A K

Evisa Çela





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKTVENDIM

Nr _____ Datë ____/____/2025

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHETIT TË MBROJTJES
CIVILE**

Kryetari Bashkisë mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, ligjin nr 45/2019 “ Për mbrojtjen civile”, VKM nr 414 datë 08.07.2021“ Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, pika 3.1 gërmat b, VKM nr.1153 datë 24.12.2020 “Për Miratimin e Uniformës, Shenjave Dalluese Përkatëse, Flamurit dhe Stëmës së Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” , ligjin nr. 115/2021 “Për Buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes nr. 2126/1 prot datë 19.02.2025 “Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2025” me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat,

V E N D O S I :

1. Të mirtatojë përdorimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit të mbrojtjes civile në shumën 2,354,267.60 lekë të detajuar si më poshtë :
 - Lagjia“Muzakaj”, Rajoni Nr.1 kemi mungesë të mureve mbajtës në këtë segment duke rrezikuar stabilitetin dhe integritetin strukturor të objekteve të banimit dhe trupit të rrugës vlere: 1,154,267.6 lekë me tvsh, l=27 ml.
 - Blerjen e tetë complete uniformash zjarrrdurese për personelin operues zjarrfikës me vlerë 1,200,000 lekë me tvsh.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve, Drejtorja e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, Drejtorja Juridike Drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave .
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Evisa ÇELA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

URDHËR EKZEKUTIMI

Bazuar në ligjin 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore ” në konfirmimin e Prefektit të Qarkut Berat.

Nr. 824 Prot, Datë 24/10 2025 për marrjen në dorëzim të aktit :

URDHËROJ

-Të zbatohet vendimi Nr. 75 Datë 20/10 / 2025 i Këshillit të Bashkisë.

-Përpiloni dhe listën e institucioneve ,ndërrmarjeve,zyrave që do t’u adresohet vendimi.

1.Ngarkohet : Drejoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, Drejtoria Juridike Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave .

-Respektoni afatet kohore dhe ligjore

KRYETARI I BASHKISË

I KOMANDUAR

ERVIN ÇECA



Sek.Këshilli Bashkiak
Bora Agalliu



**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKT- VENDIM

Nr. 74 datë 20/10/2025

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERIN Z.GABRIEL SADIK.**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 20.10.2025, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597 , datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” VKB-së nr.3, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”.

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve në raste fatkeqësie, për të ndjerin z.Gabriel Sadik në shumën 62.000 (gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë.
2. Shuma prej 62.000 (gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë, do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2025.
3. Pagesa do të bëhet për llogari të znj.Ylvia Canko, nëna e të ndjerit, që të mundësoj pagesën e shërbimit të varrimit.



4. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Social.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Evisa ÇELA

Këshilli Bashkiak e miratoi me: 22 Vota Pro, Vota Kundër, Vota Abstenim



**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKT- VENDIM

Nr. 73 datë 20 / 10 / 2025

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE NË RASTE FATKEQËSIE PËR TË NDJERIN Z.HALI KULE.**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 20 . 10 . 2025, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597 , datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” VKB-së nr.3, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”.

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve në raste fatkeqësie, për të ndjerin z.Hali Kule në shumën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.
2. Shuma prej 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2025.
3. Pagesa do të bëhet për llogari të subjektit që ka lëshuar faturën tatimore, i cili mundësojë shërbimin e varrimit.



4. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Social.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Evisa ÇELA

Këshilli Bashkiak e miratoi me: 20 Vota Pro, 1 Vota Kundër, 1 Vota Abstenim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKT-VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E NUMRIT TË KURSEVE DHE NUMRIT TË INSTRUKTORËVE TË
JASHTËM NË QKF BERAT, PËR VITIN SHKOLLOR 2024-2025**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 8 pika 1 dhe 2, Vendim nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar “ i ndryshuar, pikat 1 dhe 2, Ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë “ I ndryshuar, neni 28, pika 1 dhe 2. Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 108 datë 18.12.2024 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Berat, Drejtorisë së Arsimit për vitin 2025” dhe PBA 2025-2027

Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbledhjen e datës ____ .09.2025.

VENDOSI:

1. Të miratoje numrin e kurseve dhe numrin e instrukturëve të jashtëm në QKF Berat, për vitin shkollor 2025-2026, si më poshtë:

Sektoret	Nr	Kurset	Nr. grupeve	Nr.instruktoreve
Shkence	1	Anglisht	2	1
	2	Italisht	2	1
	3	Gjermanisht	1	1
	4	Matematike	4	2

	5	Fizike	2	1
	6	Kimi	2	1
	7	Informatike	2	1
Art	8	Pikturë	1	1
	9	Kor-solist	3	2
	10	Piano	2	1
	11	Violincel	1	1
	12	Violinë	1	1
	13	Perkusion	1	1
	14	Guida e qytetit tim	2	1
	15	Gazetari+ media virtuale	2	1
Sport	16	Futboll	1	1
	17	Volejboll	3	2
	18	Basketboll	2	2
	19	Tenis	1	1
	20	Ping-pong	3	2
	21	Arte marziale	1	1
	22	Shah	1	1
		Totali	40	27

2. Për vitin shkollor 2025-2026, QKF Berat do të funksionojë me 40 kurse dhe 27 instruktorë të jashtëm.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Drejtoria e Arsimit dhe QKF Berat.

**KRYETAR
I KËSHILLIT BASHKIAK**

Evisa Çela





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKT - VENDIM

**MBI MIRATIMIN E PROJEKTIT “PROGRAMI RAJONAL PËR DEMOKRACINË
VENDORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR 3 (RELOAD3)”**

Nr. _____, Datë .10.2025

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës .10.2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “ i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore, Ligjit Nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjin nr.162, datë 23.10.2020 “Për Prokurimin Publik,” i ndryshuar, si dhe me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Të miratojë Marrëveshjen e Bashkëpunimit “Programi Rajonal Për Demokracinë Vendore Në Ballkanin Perëndimor 3 (Reload3)” si dhe Metodologjisë për Zbatimin e Marrëveshjes.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Integritimit Evropian dhe Projekteve, Drejtoria Juridike si dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

**KRYETAR
EVISA ÇELA**

REPUBLICA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT - VENDIM

PËR

**MBI MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT TE PROJEKTIT “RiseUp-WB” TË
FINANCUAR NGA BE DHE REGJISTRIMIN E PROJEKTIT SI SHITESË NË BUXHET**

Nr. _____, Datë .10.2025

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 10.10.2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë “Për mbi miratimin e marrëveshjes së grantit të projektit “RiseUp-WB” të financuar nga BE dhe regjistrimin e projektit si shtesë në buxhet”, mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 775 datë 24.09.2010”Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë” pika 24, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 10, datë 12.07.2024 “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, Marrëveshjes së Partneritetit midis Partnerit Lider dhe Partnerëve përfitues të Projektit 101243272 “RiseUp-WB” me nr.5814 Prot., datë 10.10.2025, si dhe me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

VENDOSI :

1. Të miratojë në parim marrëveshjen e financimit të projektit RiseUP-WB

2. Të miratojë shtesat në buxhetin e bashkisë për projektin “RiseUP-WB”.

Vlera totale e projektit është 4,533,348.2 lekë, nga të cilat 3,626,698 lekë janë të ardhura direkt për bashkinë dhe bashkëfinancimi i bashkisë (20%) është në vlerën 906,669.7 lekë lekë, vlerë e cila do të mbulohet me kosto stafi. Projekti do të zgjasë 24 muaj, deri në shtator 2027.

Të ardhurat në buxhetin e bashkisë do të shtohen sipas viteve respektivë 2025-2028:

Kësti 1- 725,339.6 lekë për vitin 2025

Kësti 2- 725,339.6 lekë për vitin 2026

Kësti 3- 1,450,679.2 lekë për vitin 2027

Kësti 4- 725,339.6 lekë për vitin 2028



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

3. Shpenzimet e Bashkisë për vitet 2025-2028 të shtohen, si më poshtë:

në lekë

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Llog.	Pershkrimi	2025	2026	2027	2028
2102001		Bashkia Berat (Aparati)			725,339.6	725,339.6	1,450,679.2	725,339.6
2102001		AF102		Turizmi, Kultura dhe Sportet	725,339.6	725,339.6	1,450,679.2	725,339.6
2102001	02	AF102	602	Shpenzime operative per projekin "RiseUp WB"	725,339.6	725,339.6	1,450,679.2	725,339.6
Total Shtesa					725,339.6	725,339.6	1,450,679.2	725,339.6

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Integritimit Evropian dhe Projekteve, Drejtoria Juridike si dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

KRYETAR
EVISA ÇELA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKT – VENDIM

**PËR
REGJISTRIMIN NË BUXHET TË PROJEKTIT “HEVON IPA INTERREG SOUTH
ADRIATIC” TË FINANCUAR NGA BE**

Nr. _____, Datë / / 2025

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës / 10/2025, pasi u njoh me materialin “Për regjistrimin në buxhet të projektit “HEVON IPA INTERREG SOUTH ADRIATIC” të financuar nga BE”, në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 8 , nenit 9 pika 1, shkronja “a”, nenit 54, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Marrëveshjes së Komisionit Evropian, i cili përfaqëson Bashkimin Evropian, Republikës së Italisë dhe Republikës së Shqipërisë, për programin e bashkëpunimit “(Interreg VI-A) IPA Itali-Shqipëri-Mali i Zi (Adriatiku Jugor)” 2021-2027, Rregullorja (BE) 2021/15295 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 shtator 2021 “Për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (“IPA III”); Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 10, datë 12.07.2024 “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, Marrëveshjes së Partneritetit midis Partnerit Lider dhe Partnerëve përfitues të Projektit Hevon, Nr. 4885, datë 26.08.2025, Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 67, datë 12.09.2025 “Mbi Miratimin e bashkëfinancimit të Projektit HEVON IPA INTERREG SOUTH ADRIATIC”, VKB nr. 108 datë 18.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027” me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI :

1. Të miratojë shtesat në buxhet në vlerën 10,581,488.16 Lekë për Projektin “HEVON, Vaj Extra i Virgjër me Cilesi të Lartë dhe Rrjeti i Ndërmarrjeve të Vogla, të Mesme Konkurruese, Interreg IPA South Adriatic ”.

Ky projekt do të zgjasë 30 Muaj deri në Dhjetor 2027.

Të ardhurat në Buxhetin e Bashkisë shtohen si më poshtë sipas viteve respektive 2025-2027:

Viti 2025 - 2,138,259 Lekë
Viti 2026 - 2,855,137 Lekë
Viti 2027 - 5,588,092 Lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, Datë / / 2025

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës / / 2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Komisioni i Shpronësimeve, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 308, datë 10.05.2024, "Për ngritjen e Komisionit të Shpronësimeve në Bashkinë Berat", në mbështetje të ligjit nr. 8561 datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar dhe aktet nënligjore, VKM nr. 89 datë 03.02.2016 "Për miratimin e Hartës së Vlerës së Tokës në Republikën e Shqipërisë";

VENDOSI :

1. Të miratojë procedurën për shpronësim për interes publik për realizimin e projektit " NDËRTIMI I RRUGËS SË RE BILÇË-DROBONIK", të pasurisë private që preket nga ky projekt me vlerën **16,181,340** lekë sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Shpronësimi do të financohet me fondet e Buxhetit të Bashkisë Berat.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Komisioni i Shpronësimeve pranë Bashkisë Berat, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, Inspektoriati i Monitorimit të Territorit.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

KRYETAR
I KËSHILLIT BASHKIAK
Evisa Çela



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, datë _____ / _____ / 2025

**MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË SHTËPIZAVE TË DRURIT PËR FESTAT E
FUNDVITIT PRANË SHESHIT "TEODOR MUZAKA"**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës _____ / _____ / 2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga kryetari i bashkisë, në zbatim të nenit 8, pika 2 e nenit 9, pika 1/1, shkronja b, nenit 9 pika 1/3, shkronja b, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore",

VENDOSI :

1. Të miratojë shfrytëzimin e zonës në sheshin "Teodor Muzaka", në funksion të zhvillimit të projektit "Festat e Fundvitit" për vendosje të shtëpizave të drurit.
2. Të miratojë tarifat e përdorimit të shtëpizave të drurit për një periudhë 2(dy) muaj e 6(gjashtë) ditë në vlerën 75,000.00 lekë/muaj, afat ky që fillon më datë 01.11.2025 - 06.01.2026. Për të gjithë periudhën llogaritja do të jetë sipas formulës (Tarifa totale = (Tarifa mujore*nr e muajve) + (Tarifa mujore / 30 dite* 6)
3. Të miratojë tarifat e përdorimit të maksimumit tre shtëpizave të drurit për artizanët për një periudhë 2(dy) muaj e 6(gjashtë) ditë në vlerën 20,000.00 lekë/muaji, afat ky që fillon më datë 01.11.2025 - 06.01.2026. Për të gjithë periudhën llogaritja do të jetë sipas formulës (Tarifa totale = (Tarifa mujore*nr e muajve) + (Tarifa mujore / 30 dite* 6). Në rast se konstatohen në terren se artizanët shesin produkte jashtë fushës së tyre të veprimtarisë, në mënyrë të menjëhershme do të bëhet prishja e marrëveshjes.
4. Të miratojë një shtesë në planin e të ardhurave 2025 në vlerën 5,412,000.00 lekësh llogaria ekonomike 7109600 të ardhura nga qeratë ,për llogari të qendrës kulturore "Margarita TUTULANI", fond ky që do të përdoret për financimin e eventeve të fundvitit 2025.

- 6
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, , Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Investimeve, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Turizmit dhe Aktiviteteve, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, Qendra Kulturore "Margarita Tutulani", Agjensia e Shërbimeve Publike,
 6. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut.

KRYETAR
I KËSHILLIT BASHKIAK
Evisa Çela





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

PËR NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 108 DATË 18.12.2024
“ PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR VITIN 2025 DHE PBA
2025-2027 ”

Këshilli i Bashkisë Berat në mbledhjen e datës ____/____/2025 pasi u njoh me materialin “Për ndryshim në vendimin e këshillit bashkiak nr. 108 datë 18.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të bashkisë Berat për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027 ”, i ndryshuar, mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 40, pika 1, neni 41, pika c, 54, gërma “dh”, neni 64 gërma “c”, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 6, gërma “d”, neni 28, pika 5, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar , Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 24.01.2025 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 108 datë 18.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027”, VKB nr .86 datë 17.10.2024 “Mbi miratimin e zonave të parkimit me pagesë, tarifave të parkimeve publike: "Parkimi Goricë" dhe "Parkimi lindor i Goricës", si edhe një shtesë në numrin e përgjithshëm të punonjësve të bashkisë Berat, për menaxhimin e tyre”, VKB nr. 98 dt. 11.12.2024 “Mbi miratimin e tarifave të të përdorimit me pagesë të fushave sportive “Parku Dua të luaj” dhe miratimin e përdorimit të ambienteve të parkut “Dua të luaj” pa pagesë sipas kategorive të caktuara”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.108 datë 18.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027”, si më poshtë :

1.1 Ndryshim në planin e të ardhurave vendore, në zërat:

- - 200,000 lekë pakësim në zërin “ Taksë vendore për zënien e hapësirave publike”, llog.ekonomike 7035002
- + 2,800,000 lekë shtesë në zërin “ Të ardhura nga parkingu”, llog.ekonomike 7111007, si rezultat i të ardhurave të realizuara nga parkimi me pagesë në zonën e Goricës.
- + 350,000 lekë shtesë në zërin “ Të ardhura të tjera nga bileta”, llog.ekonomike 7114900, që burojnë nga shitja e biletave për frekuentimin fushave sportive të parkut “Dua të luaj”

Të ardhurat vendore shtohen në total me 2,950,000 lekë

1.2 Shtim në shpenzimet e bashkisë së vitit 2025 me 2,950,000 lekë në Njësinë Shpenzuese Agjencia e Shërbimeve Publike , pogrami AB102 Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile për Infrastrukturën, me destinacion financimin e punimeve për sinjalistikën rrugore horizontale në qytet me kod produkti V626AAC.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

Shtesa :

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Vlera Lek
2102004		Agjencia e Shërbimeve Publike				2,950,000
		AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile			2,950,000
2102004	05	AB102	V626AAC	602	Shpenzime mirembajtje per sinjalistiken rrugore horizontale per qytetin	2,950,000
Total Shtesa						2,950,000

1.3 Rialokimin e shpenzimeve si më poshtë :

Pakësime :

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				11,718,247
2102001		AA102	Menaxhimi & Shërbimet Mbështetëse			4,800,000
2102001	1	AA102	V112AAB	600	Shpenzime per Paga	4,000,000
2102001	1	AA102	V112AAB	601	Shpenzime per Sigurime shoqerore	800,000
2102001		AE102	Siguria dhe Mbrojtja e Territorit			1,150,000
2102001	1	AE102	V614AAB	600	Shpenzime per Paga	1,000,000
2102001	1	AE102	V614AAB	601	Shpenzime per Sigurime shoqerore	150,000
2102001		AF102	Turizmi, Kultura dhe Sportet			5,768,247
2102001	5	AF102	P822AAZ	231	Rikonstrukcion Qendra Rinore Lapardha	5,768,247
2102005		Drejtoria Arsimore Bashkia Berat				2,871,914
2102005		AC102	Arsimi & Kujdesi Social			2,871,914
2102005	1.1	AC102	V912AAK	231	Hidroizolimi i shkolles 9-vjeçare "Zihni Toska"	1,416,837
2102005	1.1	AC102	V923AAI	231	Hidroizolimi i tarraces se Konviktit "Kristo Isak" dhe i rrjetit te hidrosanitareve	26,717
2102005	5	AC102	P912ABZ	231	Punime ne permiresimin e infrastruktures ne arsimin baze, Shkolla Paftal, Njesia Administrative Sinje	767,160
2102005	1	AC102	V923AAB	602	Blerje materiale pastrimi	304,200
2102005	1	AC102	V923AAB	602	Blerje materiale te tjera	357,000
2102006		Qendra Kulturore "Margarita Tutulani"				10,000,000
		AC102	Arsimi & Kujdesi Social			10,000,000
2102006	5	AC102	V823AAC	602	Veprimtarisë kulturore dhe artistike	10,000,000
Total Pakesime						24,590,161



13

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

Shtesa :

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Shuma lek
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				11,718,247
2102001		AA102	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse			2,308,247
2102001	5	AA102	V111AAD	602	Shpenzime Operative	2,308,247
2102001		AE102	Siguria dhe Mbrojtja e Territorit			8,260,000
2102001	1	AE102	V328AAB	600	Shpenzime per Paga	3,556,000
2102001	5	AE102	V328AAB			3,460,000
2102001	1	AE102	V328AAB	601	Shpenzime per Sigurime shoqerore	1,244,000
2102001		AC102	Arsimi dhe Kujdesi Social			1,150,000
2102001	1	AC102	V014AAA	600	Shpenzime per Paga	1,000,000
2102001	1	AC102	V014AAA	601	Shpenzime per Sigurime shoqerore	150,000
2102005		Drejtoria Arsimore Bashkia Berat				2,871,914
2102005		AC102	Arsimi & Kujdesi Social			2,871,914
2102005	1.1	AC102	P912AAS	231	Blerje mjeti frigoriferik për ruajtjen dhe transportin e ushqimit të fëmijëve në kopshte, çerdhe dhe konvikt	1,443,554
2102005	5	AC102	P912AAS	231		767,160
2102005	1	AC102	V923AAB	602	Sherbime nga te trete (pagese transport nxenes)	661,200
2102006		Qendra Kulturore "Margarita Tutulani"				10,000,000
2102006		AF102	Turizmi, Kultura dhe Sportet			10,000,000
2102006	5	AF102	V823AAC	602	Veprimtari kulturore dhe artistike	10,000,000
Total Shtesa						24,590,161

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoritë e Bashkisë dhe Njësitë Shpenzuese në varësi të saj.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Evisa ÇELA



55

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKT VENDIM

**MBI MIRATIMIN E PROJEKT DOKUMENTIT TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2026-2028, FAZA e RISHIKUAR**

Këshilli Bashkiak Berat, në mbledhjen e datës ____/____/2025, pasi u njoh me materialin “Mbi miratimin e projekt dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, faza e dytë”, mbështetur në Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndyshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore ” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 8 datë 28.02.2025 “ Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2026-2028”, Udhëzimit Plotësues nr. 19 datë 10.07.2025 “Për përgatitjen e PBA Vendor 2026-2028”, VKB nr.39, datë 30.04.2025 “ Për miratimin e tavanëve përgatitore të PBA 2026-2028”, VKB nr.59, datë 29.07.2025 “ Për miratimin e tavanëve përfundimtare të PBA 2026-2028”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I :

1. Të miratojë projekt dokumentin e rishikuar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, faza e dytë
2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhimin Strategjik dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve Buxhetore.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Evisa ÇELA